



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012  
Nr. ref.: RK332/12

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 68/12

Parashtrues

**Haxhi Morina**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Haxhi Morina, me banim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Rexhep Gjokolli, avokat nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, e 26 marsit 2012, që i është dorëzuar atij më 23 maj 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimet e lartpërmendura kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 13 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI68/12, caktoi Gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI-68/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 16 shtator 2012, kërkesa i është komunikuar Gjykatës Supreme, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
8. Më 5 nëntor 2012, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Komunale në Gjakovë dhe nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përkitazi me statusin e rastit nr. SCC-06-0214, të 8 marsit 2010.
9. Më 12 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë iu përgjigj kësaj Gjykate, duke i ofruar informacionin se, parashtruesi, më 29 qershor 2011, ka parashtruar një ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 700/06, të 25 nëntorit 2010. Kjo ankesë është dërguar për shqyrtim dhe për vendim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, më 26 tetor 2011.
10. Më 14 nëntor 2012, Dhoma e Posaçme iu përgjigj kësaj Gjykate duke ofruar informacion se, sa i përket rastit SCC-06-0214, "*[...] Dhoma e Posaçme ende nuk ka vendosur në meritat e rastit. Ky rast është në pritje për t'u zgjidhur para Kolegjit Ankimor të Dhomës së Posaçme*".
11. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

12. Më 7 maj 1981, Sekretariati për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Gjakovës, (Vendimi 03-465-26/1978), ekspropriojoi pronën e paluajtshme të parashtruesit për

nevojat e SHAM "Mustafa Bakija". Në përputhje me këtë vendim, kjo pronë e paluajtshme ishte regjistruar në kadastër me emër të SHAM "Mustafa Bakija.

13. Më 12 korrik 1994, parashtruesi parashtrroi një kërkesë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të tokës në Komunën e Gjakovës, duke kërkuar kthimin e pronës së paluajtshme sepse SHAM "Mustafa Bakija" asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar pronën për qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar.
14. Më 27 maj 2008, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës (Vendimi 11, nr. 19-465-11/94-08):
  - a. Miratoi kërkesën e parashtruesit dhe ia ktheu në posedim dhe në pronësi pronën e paluajtshme, që ishte eksproprijuar nga ai;
  - b. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Gjakovës, duhet të çregjistrojë si pronar SHA "STARTI" (ish-SHAM "Mustafa Bakija") në Gjakovë dhe ta regjistrojë pronën e paluajtshme në emër të parashtruesit; dhe
  - c. SHA "STARTI" (ish-SHAM "Mustafa Bakija") në Gjakovë ishte urdhëruar t'ia kthente parashtruesit në posedim pronën e paluajtshme.

Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës konstatoi se prona e paluajtshme e eksproprijuar nuk ishte shfrytëzuar për destinimin e caktuar, p.sh.: për të ndërtuar një poligon për ushtrime praktike të shoferëve dhe të autobusëve, dhe kjo situatë faktike ishte përcaktuar gjatë vizitës së vendit nga ekspertët përkatës. Prandaj, në pajtim me nenin 8, të Ligjit për Amendamentim dhe Plotësim të Ligjit për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e KSAP, nr. 42/86), Drejtoria për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Gjakovë erdhi në konkludim se supozimet e parapara ishin përmbushur në pajtim me nenin 8, për kthimin e pronave të paluajtshme të eksproprijuara, pasi që, në afatin 5 vjet nga dita e përcaktimit të ndërtimit, shfrytëzuesi nuk e ka realizuar qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar prona e paluajtshme.

Kundër këtij vendimi ishte lejuar ankesë brenda 30 ditësh. Pasi askush nuk ishte ankuar ndaj këtij vendimi, i njëjti mori formë të prerë dhe u bë detyrues më 11 gusht 2008.

15. Parashtruesi, në pajtim me Vendimin e Drejtorisë për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës, parashtrroi një kërkesë në Agjencinë Kadastrale në Komunën e Gjakovës, për të regjistruar pronën e paluajtshme në emër të tij.
16. Më 18 nëntor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës pezulloi përkohësisht çështjen administrative për transferimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në emër të parashtruesit. Zyra Kadastrale në Gjakovë ka konstatuar se, për t'u regjistruar parashtruesi si pronar i paluajtshmërisë, është i nevojshëm pëlqimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Kosovë, e cila, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, është kompetente për ndërmarrjet shoqërore dhe për pasuritë e tyre.

17. Më 1 dhjetor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për të regjistruar pronën e paluajtshme në emrin e tij, në pajtim me Vendimin e Drejtorisë për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimin e Tokave, sepse parashtruesi nuk kishte dorëzuar pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të regjistruar pronën në emrin e tij. Zyra Kadastrale në Gjakovë konstatoi: *“Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2002/12 AKM, tash AKP administron ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore, prandaj, duke u nisur nga kjo, kërkohet gjithashtu edhe pëlqimi për transferimin e pronësisë në kadastër”*.
18. Parashtruesi parashtrroi kërkesë për rivlerësim në Zyrën Kadastrale në Komunën e Gjakovës.
19. Më 9 dhjetor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës mbështeti vendimin e 1 dhjetorit 2008. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.
20. Më 31 mars 2009, Agjencia Kadastrale e Kosovës hodhi poshtë, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe mbështeti vendimin e Zyrës Kadastrale në Gjakovë, të 9 dhjetorit 2008. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme.
21. Më 26 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. nr. 313/2009) hodhi poshtë, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vendosur në mënyrë të duhur për çështjen.

### **Procedura në Dhomën e Posaçme**

22. Më 11 maj 2006, parashtruesi inicioi një procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar që të konfirmojë pronësinë për pronën e paluajtshme të kontestuar.
23. Më 24 tetor 2006, Dhoma e Posaçme nxori një vendim (SCC-06-0214), me ç’rast ankesa kundër SHAM “Mustafa Bakija” ishte referuar në Komunën e Gjakovës për gjykim. Rasti në Gjykatën Komunale në Gjakovë ishte regjistruar me numër C. nr. 700/06.
24. Më 8 mars 2010, parashtruesi parashtrroi kërkesë për masë të përkohshme në Dhomën e Posaçme dhe në Gjykatën Komunale në Gjakovë.
25. Më 25 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 700/06) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Më 26 qershor 2011, parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Dhomën e Posaçme.
26. Më 28 gusht 2012, Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme ia komunikoi palës së paditur dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për përgjigje ankesën e parashtruesit.
27. Më 26 shtator 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit e Kosovës dorëzoi një përgjigje përkitazi me kërkesën.
28. Prandaj, përkitazi me rastin, Dhoma e Posaçme nuk ka vendosur ende për meritat e rastit. Ky rast është në pritje për t’u zgjidhur në Kolegjin Ankimor të Dhomës së Posaçme.

## **Pretendimet e parashtruesit**

29. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Vendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Vendimi i Zyrës Kadastrale në Gjakovë, janë marrë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse parashtruesi ka marrë një vendim të formës së prerë dhe të detyrueshme nga Drejtoria për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimi i Tokës në Komunën e Gjakovës, më 27 maj 2008, i cili miratoi kërkesën e parashtruesit dhe i ktheu në posedim dhe në pronësi pronën e paluajtshme që ishte eksproprijuar nga ai. Më tej, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Ambientit në Komunën e Gjakovës ishte urdhëruar që të regjistronte pronësinë në emrin e parashtruesit.
30. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Agjencia Kosovare e Privatizimit është vënë mbi ligjin, sepse Agjencia Kadastrale ka kërkuar nga parashtruesi që ta ketë pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ta regjistruar pronësinë e pronës së paluajtshme.
31. Për më tepër, parashtruesi pretendon se procedura për kthimin e pronës ishte iniciuar para se të themelohej Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit asnjëherë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim procedural.
32. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, neni 24 [Barazia para Ligjit], sepse Dhoma e Posaçme ka miratuar kërkesën e fqinjëve të parashtruesit për masë të përkohshme, përdërisa kërkesa e parashtruesit pretendohet se as nuk është shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme, edhe pse rasti ishte identik me atë të fqinjëve.
33. Për më shumë, parashtruesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë pretendohet të jetë shkelur.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

34. Parashtruesi pretendon se ishte shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
35. Sa i përket Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012, me ç'rast ishte hedhur poshtë si e pabazuar ankesa e parashtruesit dhe ishte mbështetur vendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).
36. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe para organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian*

*për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).*

37. Në rastin konkret, parashtruesi thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar tërësisht ligjin e zbatueshëm dhe nuk pajtohet më gjetjet faktike të Gjykatës Supreme përkitazi me rastin e tij.
38. Faktikisht, parashtruesi nuk e ka mbështetur ankesën në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se, nga Gjykata Supreme, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për papranueshmëri të Kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).
39. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar si dhe pse Gjykata Supreme ka vendosur “në mënyrë të njëanshme”, duke i mohuar kështu të drejtën e tij në pronë.
40. Del se kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.
41. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, Gjykata thekson se mund të vendosë për pranueshmëri të një kërkesë vetëm nëse parashtruesi tregon se ai/ajo i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit që parasheh:

*Neni 113.7 i Kushtetutës: “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”;*

*Neni 47.2 i Ligjit: “Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

42. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t’u ofrojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010; dhe shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).
43. Në rastin konkret, Gjykata gjen se parashtruesi ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr 700/06, në Kolegjin Ankimor të Dhomës së Posaçme, duke pretenduar se ai është pronar i pasurisë së paluajtshme, sepse SHAM “Mustafa Bakija” asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar për qëllimet që ishte ekspropriuar, dhe kërkoi që SHAM “Mustafa Bakija”, nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit të Kosovës, t’ia njohë të drejtën e pronësisë dhe t’ia lejojë ta regjistrojë në regjistrat e kadastrës. Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme ende nuk ka nxjerrë një vendim për këtë çështje.
44. Del se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 (2) të

Ligjit, sepse çështja se kush është pronari i ligjshëm i pasurisë së paluajtshme të kontestuar ende nuk është zgjidhur nga Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme.

45. Për këto arsye, kërkesa është e papranueshme.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

